



Nr./Br. 2382-2017

Në pajtim autorizim e dhëna nenin 105, 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.11.2017, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal 2017

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotim dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, si dhe të gjitha apelimet e bëra që u përkasin votimit dhe numërimit, janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin Komunal, të mbajtura më 22 Tetor 2017, për komunat si vijon:

Gjakovë, Deçan, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpç, Suharekë, Ferizaj, Viti, Zubin Potok, Zveqan, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graqanic, Ranilluk, Partesh, Kllokot, Mitrovicë e Veriut.
- II. Ndërsa për komunën e Vushtrrisë, KQZ rezultatet për Kuvendin Komunal, do ti certifikoj pas përfundimit të afatit të ankesës në Gjykatën Supreme.
- III. Rezultatet e zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati, që rezultatet e certifikuar përfundimtare të zgjedhjeve t'i publikojë në formë tabelare, në pajtim me këtë vendim.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 29.11.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

